

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6515
E premte, 21 janar 2022
çmimi 0.40 €

Gërvalla në Athinë: Njohja e Kosovës nga Greqia do të përbente një hap historik.



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KUVENDI I KOSOVËS KA MBAJTUR DEBAT PARLAMENTAR
PËR RITJEN E ÇMIMEVE NË VEND

OPOZITA KËRKON ANULIMIN E PROPOZIMIT PËR RITJEN E ÇMIMIT TË RRYMËS



Partitë opozitare kanë kërkuar anulimin e propozimit të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZrRE) për ritjen e çmimit të energjisë elektrike. Në debatin parlamentar për ritjen e çmimeve, deputetët e subjekteve opozitare e kanë akuzuar qeverinë për keqmenaxhim të situatës me energji elektrike. Sipas tyre, ritja e çmimit të energjisë elektrike do të ndikojë edhe në ngritjen e prodhimeve. Përfaqësuesit e pushtetit kanë arsyetuar propozimin për shtrenjtimin e energjisë elektrike duke thënë se në këtë situatë nuk ka alternativë tjetër

AKTUALE



**MUHAXHERI: HERA E PARË
QË QEVERIA NUK KA NDARË
ASNJË CENT PËR PEJËN** F.3

**TË RINJTË DERI 19 VJEÇ, MË TË
PREKURIT NGA COVID NË 24 ORËT
E FUNDIT** F.3

**COVID-19, FORMOHEN EKIPET
MOBILE TË QKMF-së NË SHKOLLAT
E PRIZRENIT** F.6

EKONOMI



**KËRKOHEM AMBIENT
MË I FAVORSHËM PËR
KOMPANITË VENDORE** F.7

**KUSH DO TË PAGUAJË MË SHUMË
PËR RRYMË?** F.8

SPORT



**KLUBET E FUTBOLLIT MBUSHIN
'BATERITË' NË TURQI** F.10

Blinken: Pasoja të mëdha për Rusinë nëse sulmon Ukrainën



VAZHDON RITJA E MADHE E RASTEVE ME COVID NË KOSOVË, PARALAJMËROHEN MASA TË REJA

FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Blinken: Pasoja të mëdha për Rusinë nëse sulmon Ukrainën

WASHINGTON, 20 JANAR - Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken dhe aleatët kryesorë të Uashingtonit në Evropë, kanë lëshuar një paralajmërim tjetër për Rusinë për "pasoja të rënda" nëse ajo vepron në mënyrë agresive ndaj Ukrainës. Ky shqetësim vjen pasi kanë kaluar disa javë që Moskë ka përforcuar me ushtarë kufirin me Ukrainën. Sekretari Blinken, tha në Berlin më 20 janar 2022, se nëse ndonjë forcë ruse lëviz përtej kufirit ukrainas, do të ketë një "përgjigje të shpejtë dhe të ashpër nga Shtetet e Bashkuara dhe aleatët dhe partnerët tanë". Këto komente Blinken i bëri pas takimit me aleatët nga Gjermania, Franca dhe Mbretëria e Bashkuar. Duke folur në një konferencë të përbashkët shtypi me sekretarin amerikan të shtetit, Blinken, Ministrja e Jashtme gjermane, Annalena Baerbock, tha se ata "i bëjnë thirrje Rusisë të ndërmarrë hapa drejt një depërshkallëzimi" të situatës. "Çdo qëndrim i mëtejshëm agresiv, çdo agresion i mëtejshëm, do të kishte pasoja të rënda", tha



Baerbock. Takimi i aleatëve vjen një ditë përpara se Blinken të shkojë në Gjenevë për bisedime me ministrin e Jashtëm rus Sergei Lavrov. Alarmet kanë rënë në të gjithë kryeqytetet perëndimore për rrezikun e një konflikti të ri të madh pasi Rusia grumbulloi rreth 127 mijë trupa përgjatë

kufijve të Ukrainës dhe vendosi një forcë të konsiderueshme në Bjellorusi për atë që Moskë dhe Minsku thonë se do të jenë stërvitje ushtarake. Blinken tha se Rusia mund të përdorë një gamë të gjerë veprimesh për ta destabilizuar situatën, duke përfshirë sulme hibride dhe paraushtarake në

Ukrainë. Blinken vizitoi Kievin një ditë më parë për ta siguruar Ukrainën se kishte mbështetjen e Uashingtonit, duke thënë se nëse Rusia vazhdon me ndonjë lëvizje agresive kundër Ukrainës, Shtetet e Bashkuara janë të përgatitura të ofrojnë materiale shtesë për Kievin për ta ndihmuar atë që të mbrohet.

Presidenti i SHBA-së, Joe Biden, tha në një konferencë shtypi më 19 janar, se Rusia do të përballet me pasoja të rënda ekonomike nëse ndodh një ofensivë ushtarake. "Unë nuk jam aq i bindur se ai është i sigurt se çfarë do të bëjë. Mendoj se ai do të ndërtojë. Ai duhet të bëjë diçka", tha Biden në një konferencë shtypi për të shënuar vitin e tij të parë në detyrë.

Kievi zyrtar ka mirëpritur sinjalizimin e presidentit amerikan Joe Biden se do të ketë një përgjigje të koordinuar me aleatët në rast se Rusia tenton ta pushtojë Ukrainën. Kremlini, i cili mohon planifikimin e një sulmi, tha më 20 janar se paralajmërimet e tilla të SHBA-së mund ta destabilizojnë më tej situatën. Në anën tjetër, sekretari amerikan i shtetit, Blinken, ka shfaqur shpresë se pavarësisht prej indikacioneve se Rusia vazhdon të grumbullojë trupa pranë Ukrainës, bisedimet e tij të ardhshme me ministrin e Jashtëm të Rusisë, Sergej Lavrov, do të tregojnë "se diplomacia mbetet një mundësi e hapur".

Miliona njerëz po vdesin nga infeksionet që u rezistojnë ilaçeve



NJU-JORK, 20 JANAR - Infeksionet e shkaktuara nga bakteret rezistuese ndaj antibiotikëve kanë lënë të vdekur më shumë se 1.2 milion persona më 2019, është thënë në atë që është përshkruar si studimi më i madh për këtë çështje. Kjo shifër është më e lartë sesa ajo e vdekjeve vjetore nga malaria dhe AIDS-i. Shtetet e varfra janë më të prekurat nga rezistenca ndaj baktereve, e cila kërcënon shëndetin e secilit, është thënë në raportin e publikuar nga revista mjekësore "The Lancet".

Në të rekomandohet që të ketë investime urgjente në ilaçe të reja dhe që ato që ekzistojnë të përdoren më mirë. Përdorimi i tepruar i antibiotikëve për infeksione jo shumë të rënda, nënkupton se ato po bëhen më pak efektive kundër infeksioneve serioze. Njerëzit janë duke vdekur nga infeksione që më parë janë trajtuar, pasi bakteret që shkaktajnë ato janë bërë rezistente ndaj trajtimeve. Shifrat për vdekjet janë të bazuara në studime të kryera në 204 shtete

nga një ekip i hulumtuesve ndërkombëtarë, i udhëhequr nga Universiteti i Uashingtonit në Shtetet e Bashkuara. Hulumtuesit besojnë se rreth 5 milionë njerëz kanë vdekur më 2019 nga sëmundje ku ka pasur rol rezistenca ndaj baktereve, ndërsa .2 milion vdekje kanë qenë të shkaktuara drejtpërdrejt nga ky problem. Shumica e vdekjeve nga rezistenca ndaj baktereve janë shkaktuar nga pneumonia apo infeksione të tjera të frymëmarrjes dhe infeksioneve të gjakut që çojnë në sepsë.

Në Tonga arrin aeroplani i parë me ndihma

WELLINGTON, 20 JANAR - Në Tonga ka arritur aeroplani i parë me ndihma, përfshirë ujin dhe furnizime të tjera tejet të nevojshme për këtë ishull të Paqësorit. Zelanda e Re ka thënë se aeroplani i saj ushtarak ka ateruar në aeroportin kryesor të Tongas, pasi punëtorët kanë hequr hirin nga pista. Tashmë janë nisur edhe

aeroplanë dhe anije të tjera me ndihma nga Zelanda e Re dhe Australia. Shpërthimi i vullkanit të shtunën, i përcjellë nga një cunami, ka mbuluar ishullin me hi, duke rrezikuar shëndetin e banorëve. Hiri dhe uji i detit kanë kontaminuar furnizimet me ujë. Të paktën tre persona kanë vdekur dhe komunikimet kanë

qenë të bllokuara për disa ditë, duke lënë këtë vend pa kontakt me botën. Si autoritetet australiane, ashtu edhe ato të Zelandës së Re, kanë konfirmuar se furnizimet do të dërgohen pa kontakt, me qëllim të parandalimit të përhapjes së koronavirusit në këtë ishull, i cili ka raportuar vetëm një rast me koronavirus gjatë gjithë pandemisë.



Vazhdon rritja e rasteve me Covid në Kosovë, paralajmërohen masa të rrepta

Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar të enjten se, sipas të dhënave nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike, prej 10 833 testeve, 2 708 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit është shënuar edhe një rast i vdekjes

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 20 JANAR - Gjithsej 2 708 raste të reja me Covid-19 janë regjistruar në Kosovë në 24 orët e fundit, ka njoftuar Ministria e Shëndetësisë. Sipas MSh-së, në 24 orët e fundit janë testuar 10 833 qytetarë.

Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit është regjistruar një rast i vdekjes nga Covidi.

Bazuar në të dhënat e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (ISHKPK), 25 për qind e rasteve të testuar kanë rezultuar pozitivë.

Një ditë më parë, më 19 janar, autoritetet shëndetësore në Kosovë kanë regjistruar 2 050 raste të infektimit. Sipas Ministrisë së Shëndetësisë, në 24 orët e fundit janë dhënë gjithsej 4 731 doza të vaksinës kundër Covid-19.

Aktualisht në Kosovë me Covid-19 janë 9 771 raste.

Sipas raportit të punës të datës 20 janar, në Shërbimin Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës në trajtim mjekësor nga Covid-19 janë 100 pacientë. Prej këtyre, 70 të konfirmuar me Covid-19 dhe 30 të tjerë post-Covid.

Me oksigjenoterapi janë 49 pacientë, kurse në Mjekimin Intensiv të Klinikës Infektive janë dy pacientë me maskë oksigjeni.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKShPK) ka konfirmuar se pothuajse të gjitha këto raste


janë të variantit Omicron, i cili përhapet jashtëzakonisht shpejt dhe lehtë në krahasim me variantet e mëparshme të virusit Korona.

Të enjten kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka kërkuar përditësim të masave për luftim të pandemisë së koronavirusit.

IKShPK-ja ka njoftuar se Omicroni po vazhdon ta shtojë intensitetin dhe është varianti dominues në qarkullim. "Virusi është kudo, andaj mos neglizhoni rekomandimet themelore: maskën, distancën, higjienën. Shmangni udhëtimet, qëndroni në shtëpi dhe ajrosni ambientet e mbyllura", ka njoftuar IKShPK-ja.

Pas rritjes së ndjeshme të rasteve pozitive të Covid-19 gjatë ditëve të fundit, të enjten është mbajtur mbledhja e komitetit për koordinim dhe vlerësim të situatës me pandeminë Covid-19.

Sipas njoftimit të MSh-së, në këtë takim u tha se ngadalësimi i rritjes së numrit të rasteve do të sigurojë që funksionimi i sistemit shëndetësor të mos rrezikohet nga një fluks i madh dhe i përnjëhershëm i pacientëve nëpër spitale, apo nga mungesa e punonjësve shëndetësorë të infektuar. "Po ashtu, një ngadalësim i tillë do t'u japë kohë qytetarëve që të vaksinohen sa më masivisht, qoftë me dy dozat e para, qoftë me dozën përfunduese. Kjo do t'u ofrojë mbrojtjen prej infektimit apo sëmundjes së rëndë, si dhe do ta ndihmojë Kosovën në tërësi, që të kalojë



sa më shpejt valën aktuale dhe me sa më pak pasoja", ka njoftuar Ministria e Shëndetësisë.

Ministri Latifi viziton Klinikën Infektive në QKUK

Ministri i Shëndetësisë, Rifat Latifi, ka vizituar të enjten në mëngjes Klinikën Infektive në QKUK, ku me ekipin kujdestar të 24-orëshit të fundit ka biseduar për pacientët që po trajtohen aty.

Ministri Latifi ka falënderuar ekipet për punën që po bëjnë dhe, së bashku edhe me drejtorin e ShSKUK-së, Valbon Krasniqi dhe drejtorin e Klinikës Infektive, Arben Vishaj, biseduan për organizimin e punës për frymën e rritjes së rasteve me Covid-19 dhe për gatishmërinë për t'u ballafaquar në rast të rritjes së rasteve. Ai u informua për numrin e rasteve që kanë marrë trajtim gjatë 24-orëshit të fundit dhe ecurinë e tyre.

Të rinjtë deri 19 vjeç, më të prekurit nga Covid në 24 orët e fundit

Bazuar në të dhënat e Ministrisë së Shëndetësisë së Kosovës, grupmosha më e prekur nga infektimi me Covid-19 në 24 orët e fundit është 10 deri 19 vjeç. Sipas këtij institucioni, 899 raste pozitive i takojnë kësaj grupmoshe. Por numër i lartë i personave të infektuar është raportuar edhe te grupmosha më e re, 0 deri në 9 vjeç, gjithsej 181 raste. Këto dy grupmosha përbëjnë 1 080 nga gjithsej 2 708 rastet pozitive të raportuara nga Ministria e Shëndetësisë më

20 janar 2022. Një grupmoshë tjetër e prekur më shumë nga infeksioni është 30 deri 39 vjeç me gjithsej 406 raste, pasuar nga grupmosha tjetër 40 deri 49 vjeç me gjithsej 403 raste pozitive. Simptomat që manifestojnë fëmijët e prekur me koronavirus, sipas mjekëve, janë të lehta: temperaturë, kollë dhe rrjedhje hundësh. Trajtimi i tyre kryesisht bëhet me ilaçe për ulje të temperaturës, shurupe për kollitje, lëngje, pemë, perime dhe vitamina.

Muhaxheri: Hera e parë që qeveria nuk ka ndarë asnjë cent për Pejë

PEJË, 20 JANAR - Kryetari i komunës së Pejës, njëherësh nënkryetar i LDK-së në nivel qendror, Gazmend Muhaxheri, ka deklaruar se viti 2021/22 është hera e parë në historinë e pasluftës që qeveria qendrore nuk ka ndarë asnjë cent drejtpërdrejt për projekte në komunën e Pejës.

Deklaratën Muhaxheri e ka

bërë të enjten në 'RADIO 1'. "Kemi pasur qeverisje të shkuara, bile që kanë pasur ministra edhe nga partitë e tjera, jo nga LDK-ja që janë ofruar, kanë kërkuar projekte, kanë marrë mendime, kanë pranuar planet dhe prioritetet tona dhe kemi bashkëpunuar. Qeveria e Kurtit është kjo qeveri e cila asnjë cent për Pejë

radhe nuk e ka ndarë, pra për komunën. Investimi i planifikuar për Spitalin Rajonal të Pejës, që kanë thënë se do ta bëjnë, e mirëpresim, është rajonal dhe është mirë. Por po flas për komunën e Pejës, asnjë cent. Se a do të ketë në të ardhmen, presim mos po ndodh më 2023", ka thënë Muhaxheri.





KUVENDI I KOSOVËS KA MBAJTUR DEBAT PARLAMENTAR PËR RITJEN E ÇMIMEVE NË VEND

Opozita kërkon anulimin e propozimit për rritjen e çmimit të rrymës

Partitë opozitare kanë kërkuar anulimin e propozimit të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRë) për rritjen e çmimit të energjisë elektrike. Në debatin parlamentar për rritjen e çmimeve, deputetët e subjekteve opozitare e kanë akuzuar qeverinë për keqmenaxhim të situatës me energji elektrike. Sipas tyre, rritja e çmimit të energjisë elektrike do të ndikojë edhe në ngritjen e prodhimeve. Përfaqësuesit e pushtetit kanë arsyetuar propozimin për shtrenjtimin e energjisë elektrike duke thënë se në këtë situatë nuk ka alternativë tjetër

kryeministri nuk po del me asnjë ide e asnjë alternativë për sfidat ekonomike sociale dhe energjetike të vendit. “Kryeministri i shtetit nuk mbahet mend duke dhënë zgjidhje, përveç vajtimit të periudhës së kaluar 20-vjeçare”, është shprehur ai.

Edhe shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Arben Gashi, e ka kundërshtuar propozimin për shtrenjtimin e energjisë elektrike. “Qytetarët e Kosovës po përballen me një krizë të jashtëzakonshme dhe me një kërcënim nga qeveria për rritjen e çmimit të energjisë rreth 300 për qind. Para një viti kryeministri i sotëm e projektonte veten si një magjistar politik që do ta ndryshonte edhe rendin botëror. E kishte krijuar përshtypjen për vete që bota ishte në pritje të tij, e tani kur nuk ka kaluar ende një vit, është shndërruar në një politikan akrobat, i cili i ik thelbit të çdo problemi dhe krijon probleme pa fund”, ka thënë Gashi. Sipas tij, kryeministri Kurti i ka refuzuar të gjitha zgjidhjet e mundshme sa i përket energjisë. “Si një politikan akrobat e ka shndërruar Kosovën

në një cirk terri, ku shfaqja e tij e radhës quhet mungesa e energjisë elektrike, ndërsa për ta konsumuar atë bileta kushton 300 për qind më shtrenjtë. Ky kryeministër i ka refuzuar të gjitha zgjidhjet e mundshme sa i përket energjisë. Derisa ky kryeministër nuk na befason ne dhe botën me ndonjë akt magjik, paaftësia qeverisëse do të mbajë emrin e tij”, ka deklaruar ai.

Kurse shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka thënë se janë mbi 200 mijë familje që shpenzojnë mbi 800 kilovatë. “Kuvendi po e nis sesionin pranveror me një situatë dhe krizë energjetike e cila ka rrezik ta sjellë vendin, qeverinë dhe qytetarët në bankrotim total. Kryetarja e grupit parlamentar e LV-së, Mimoza Kusari-Lila, e bëri një analizë të shteteve të rajonit që mund të them me pasaktësi të shumta. Maqedonia e ka rritur veç për 9 për qind çmimin, Shqipëria shumë herët ka nisur të diskutojë për krizën energjetike, Kosova paguan 21 euro për 1 orë KW, 1 euro më shumë paguan Anglia dhe paguan më shumë Italia. A je në mend çka je t’u fol?”, ka deklaruar Tahiri.

Kurti: Kemi paguar 2.5 milionë euro për import të energjisë

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka mohuar kritikën e opozitës. Para deputetëve ai e ka arsyetuar propozimin për rritjen e çmimit të energjisë elektrike. Ai ka bërë me dije se totali i gjenerimit të energjisë elektrike, me kapacitet vendor më 19 janar, ka qenë 727 megavatë, ndërsa konsumi ka arritur deri në 1 317 megavatë. Kurti ka thënë se çmimi bazë për megavat në orë ka qenë 227 euro, ndërsa çmimi maksimal 245 euro. “Unë po marr vetëm shembullin e ditës së djeshme, 19 janar 2022. Në ditën e djeshme i kemi pasur në punë A1, A2 dhe A3. Ka punuar edhe B1 me 251 megavatë. B2 vazhdon të jetë jashtë funksionit. Totali i gjenerimit të energjisë me kapacitetet tona ka qenë 727 megavatë. Piku ka qenë 1 317 megavatë. Në ditën e djeshme importi është mbi 10 gigavatë orë, ndërsa devijimi është mbi 400 megavatë orë. Në bursën ndërkombëtare çmimi bazë ka qenë 227 euro. Vetëm

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 20 JANAR - Deputetët e Kuvendit të Kosovës të enjten kanë zhvilluar një debat të nxehtë për çmimin e energjisë elektrike pas propozimit të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRë).

Përfaqësuesit e qeverisë e kanë arsyetuar këtë propozim, kurse ata të opozitës e kanë kundërshtuar. Në debatin parlamentar për ngritjen e çmimeve, deputetët e partive opozitare e kanë akuzuar Qeverinë e Kosovës për keqmenaxhim të situatës me energji elektrike dhe i kanë

kundërshtuar propozimet për rritje të çmimit të energjisë.

Deputeti i PDK-së, Ferat Shala, ka thënë se ngritja enorme e çmimit në sektorin e energjisë do të reflektojë në tërë zinxhirin e prodhimeve dhe konsumit ditor. “Për nivelin e lartë të ngritjes së çmimeve në shportën e konsumatorit, sot nën qeverisjen Kurti qytetarët shpenzojnë më shumë, ushqehen më pak; shpenzojnë më shumë, udhëtojnë më pak; shpenzojnë më shumë, marrin shërbim të njëjtë, punojnë më shumë e të ardhura të njëjta; shpenzojnë shumë e jetojnë shumë më keq”, ka deklaruar Shala. Ai ka thënë se

Gërvalla në Athinë: Njohja e Kosovës nga Greqia do të përbënte hap historik

PRISHTINË, 20 JANAR (ER) - Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, është takuar të enjten në Athinë me ministrin e Punëve të Jashtme të Greqisë, Nikos Dendias. Në takimin e dytë që zhvilluan homologët brenda pak muajsh, pas atij në Prishtinë, patën rastin të diskutojnë në terma konkretë format e bashkëpunimit dypalësh. Duke e falënderuar për pritjen, ministrja Gërvalla ka shprehur gatishmërinë e Qeverisë së Kosovës për t'i avancuar marrëdhëniet bilaterale me Republikën Helenike, e cila, sipas saj, është një shtet i rëndësishëm në rajonin e Evropës Juglindore dhe, gjithashtu, kontribuues i rëndësishëm për sigurinë dhe

stabilitetin e rajonit. Ministria Gërvalla, po ashtu, ka theksuar se Kosova e konsideron Greqinë shtet mik dhe partner dhe e çmon për konstruktivitetin në raport me agjendën evropiane dhe procesin e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. Më tej kryediplomatët theksuan rëndësinë e avancimit të mëtejshëm të marrëdhënieve ekonomike, në veçanti diskutuan lidhur me bashkëpunimin në fushën e energjisë. Ministria Gërvalla ka bërë me dije se Kosova ndodhet në fazën e shqyrtimit të opsioneve më të mira sa i përket strategjisë energjetike. "E ardhmja jonë energjetike ngërthen në vete energjinë tradicionale dhe të ripërtëritshme. Ne jemi në

kontakt me miqtë tanë për opsionet për tranzicionin sfidues në këtë fushë. Ne do të vazhdojmë të jemi në kontakt të ngushtë me Greqinë për hollësitë dhe për vendimet tona në këtë drejtim", ka theksuar ajo. Gjithashtu, ministrja e Jashtme e Kosovës ka ripërsëritur aspiratat e qeverisë dhe të qytetarëve të Kosovës për integrim euroatlantik. Në këtë kontekst, ka përmendur angazhimin e madh të qeverisë së re në forcimin e sundimit të ligjit si një parakusht për fuqizim dhe demokratizim të mëtejshëm të vendit. Para palës greke, ministrja Gërvalla ia shpalosi ofertën e Kosovës sa iu përket mundësive të favorshme të të bërit biznes. Një kornizë konkurruese me

taksa të ulëta dhe pa burokraci e me një potencial të madh njerëzor për punë profesionale, sipas kryediplomates Gërvalla, janë arsye të mira që Kosova të konsiderohet nga investitorët e huaj, të cilët mund të ekspolorojnë mundësi të ndryshme të investimeve direkte. Ministria Gërvalla, po ashtu, ka theksuar se njohja dhe respektimi i pavarësisë së Kosovës nga të gjithë anëtarët e Bashkimit Evropian, përfshirë Greqinë, do të ishte një lëvizje e guximshme për stabilitetin në rajon dhe më gjerë, që do ta mundësonte hapjen e një dinamike të re në zgjidhjen e problemeve afatgjata në Ballkan. "Jo vetëm për vendet tona, por më shumë për fëmijët dhe

nipërit tanë, ky do të ishte një premtim për stabilitet dhe paqe të qëndrueshme në Evropë. Një hap i tillë do të ishte historik dhe mendojmë se është diçka që duhet të bëhet", ka theksuar Gërvalla. Në takim u diskutua edhe për çështje të politikës së jashtme, çështje evropiane dhe rajonale. Bashkëbiseduesit kishin në fokus edhe nevojën për ta zgjeruar formën e bashkëpunimit në fusha të tjera si kultura, shkenca, arsimit dhe shëndetësia. Nga ana e tij, kryediplomati grek Dendias ka theksuar se Ballkani Perëndimor duhet të shikojë kah e ardhmja dhe jo nga e kaluara. Sipas Dendias, perspektiva e vendeve të Ballkanit Perëndimor është perspektivë që ka vetëm një rrugë e cila është Evropa.



importi dhe ka kushtuar 2.5 milionë euro. Prandaj, deputetë të nderuar, më tregoni si ta paguajmë rrymën", ka thënë Kurti. Në këtë seancë shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, Abelard Tahiri, ka thënë se në proces do të kenë një mocion procedural që lidhet me këtë çështje dhe i ka ftuar partitë e tjera në Kuvend që ta mbështetin, por ky mocion nuk është mbështetur. Propozimi i Zyrës së Rregullatorit për Energji për ngritje të tarifave të energjisë së shpenzuar elektrike i ka ndarë konsumatorët në pesë kategori:

A, B, C, D, E. Sipas ZRRë-së, rritja e çmimit të energjisë prek vetëm dy kategori të amvisërive, D dhe E, përkatësisht ata qytetarë që shpenzojnë mbi 800, përkatësisht mbi 1 000 kilovatë. Për kategorinë D, që shpenzon 800 kilovatë orë energji elektrike në muaj, fatura pritet të rritet për 12 euro e 31 centë. Për qytetarët në kategorinë E, që shpenzojnë 1 000 kilovatë orë energji elektrike në muaj, fatura pritet të rritet për 24 euro e 62 centë.

PDK-ja kërkon rezolutë kundër ngritjes së çmimit të rrymës

Shefi i grupit parlamentar i

PDK-së, Abelard Tahiri, ka bërë me dije se kjo parti do të iniciojë seancë të jashtëzakonshme për të diskutuar rritjen e çmimit të energjisë elektrike. Në një konferencë për medie, ai ka thënë se në këtë seancë do të kërkohet miratimi i një rezolute kundër shtrenjtimit të energjisë elektrike. "Sot GP i PDK-së, duke parë gjendjen që po rëndohet çdo ditë e më shumë me energji elektrike, në anën tjetër duke parë papërgjegjësinë e kryeministrit dhe të qeverisë, kërkoi që të mbajë një debat në lidhje me këtë situatë. Në mënyrë që qytetarët të kalojnë sa më lehtë

këtë dimër, kërkojmë që në asnjë rrethanë të mos ngritet çmimi i energjisë. Kjo është e papërbalueshme për qytetarët dhe nuk bën të ndodhë", ka thënë ai. Tahiri i ka kritikuar deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje për mospërkrahje të mocionit të PDK-së, duke thënë se Kosova është vendi i fundit që po diskuton për ndërmarrjen e masave lidhur me rritjen e çmimit të energjisë elektrike. "Si po shkon puna, Kosova do të jetë një nga 10 vendet që do të paguajë më së shtrenjti energjinë elektrike në Evropë. Është duke u manipuluar me të madhe në lidhje me shifrat dhe

statistikat për furnizim nga ana e qeverisë. Si opozitë ne nuk do të ndalemi. Do të punojmë dhe do t'i përdorim të gjitha instrumentet për të ftuar në seancë të jashtëzakonshme kryeministrin Kurti që të mos lejojë ngritjen e çmimit të energjisë. Secila familje e Kosovës, sado e vogël të jetë ajo, do të kalojë 600 kwh energji elektrike brenda muajit dhe do të preket nga rritja e çmimit të energjisë. Pagat nuk janë rritur, prandaj pagat e qytetarëve tanë, mësuesve, policëve, të sektorit privat, nuk do të mund ta përballojnë rritjen e çmimit të energjisë", ka theksuar Tahiri.

Covid-19, formohen ekipet mobile të QKMF-së në shkollat e Prizrenit

PRIZREN, 20 JANAR - Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, së bashku me drejtoreshën e Arsimit, Luljeta Gutaj-Veselaj, drejtoreshën e Shëndetësisë, Burbuqe Berisha dhe me bashkëpunëtorë, vizituan disa shkolla dhe çerdhe në komunën e Prizrenit. Totaj ka thënë se Drejtorja e

Shëndetësisë dhe Drejtorja e Arsimit dhe Shkencës kanë formuar ekipet mobile të QKMF-së dhe grupet e taskforcave nëpër shkolla. "Këta persona po kujdesen për testimin me teste rapide për fëmijët me simptoma dhe për parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19. Këto teste realizohen brenda objekteve

shkollore nga ana e ekipeve mobile të QKMF-së. Të gjithë personat relevantë, së bashku me drejtoreshat, janë 24 orë në shërbim për ta siguruar mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe për të mundësuar parandalimin e përhapjes së virusit me shpejtësi të fëmijët", ka thënë Totaj.



Hyseni: Jemi të interesuar që Gjilanin ta kthejmë në model të funksionimit të ambientit

GJILAN, 20 JANAR - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ka paralajmëruar zhvillimin e një strategjie për një ambient të pastër dhe të shëndetshëm në këtë qytet, gjatë një vizite që ka bërë sot në kompaninë 'Ecohigijena', e cila funksionon në partneritet publiko-privat me komunën që prej gati dhjetë vjetësh.

Hyseni e ka vizituar këtë kompani me rastin e pranimit të një kontingjenti prej 3 mijë kontejnerësh për përdorim familjar, të madhësisë 120 litra, donacion nga GIZ-i gjerman. Ai ka thënë se në kuadër të projektit për bashkëpunim me komunën e Gjilanit, nga GIZ-i gjerman të enjten ka arritur një kontingjent tjetër i kontejnerëve dhe tani do të diskutohet me kompaninë për mënyrën e zhvillimit të mëturshëm të strategjisë së grumbullimit dhe menaxhimit të mbeturinave. "Për aq sa jam informuar, mbulimi me shërbime në

grumbullimin e mbeturinave është rreth 82 për qind dhe e njëjta gjë duhet të jetë edhe në procesin e pagesës", ka thënë Hyseni.

Për më tepër, Hyseni ka theksuar se me këta kontejnerë tani komuna e Gjilanit duhet të bëhet një model i menaxhimit të mbeturinave dhe i ambientit të pastër e të mirë. "Ne jemi të interesuar që Gjilanin ta kthejmë në një model të funksionimit të ambientit, në një ambient ekologjik dhe të pastër dhe ky donacion i kontejnerëve është pikënisja fillestare e një strategjie të mirëfilltë e të përbashkët me kompaninë", ka vlerësuar Alban Hyseni.

Ndërkaq, përfaqësuesi i kompanisë, Senad Ramaj, ka thënë se me këtë kontingjent të kontejnerëve, tani secila familje do të ketë një të tillë, prandaj pret që një shërbim i mirë të përcillet edhe me pagesa të rregullta.



Latifi dhe drejtoresha Sallteku takohen me punonjësit shëndetësorë



RAHOVEC, 20 JANAR - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, i shoqëruar nga nënkryetari Fatmir Iska dhe drejtoresha e Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale, Saranda Sallteku, kanë vizituar punonjësit shëndetësorë në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare "Fahredin Hoti", ku janë pritur nga drejtori dr. Ebunit Kryeziu. Në hapje të takimit drejtori Kryeziu e ka falënderuar kryetarin Latifi për vizitën dhe mbështetjen e dhënë në ecurinë e punëve në sektorin e

shëndetësisë, i cili, ndër të tjera, ka paraqitur edhe drejtoreshën Saranda Sallteku, me të cilën drejtori ceku që do të jenë bashkëpunues gjatë gjithë kohës. Drejtoresha Sallteku shprehu mirënjohje për punëtorët shëndetësorë dhe luti që ta kryejnë punën e tyre ashtu siç është e përcaktuar me ligje dhe rregullore në fuqi, duke kërkuar që të respektohet orari i punës. Kryetari Latifi ka uruar fillimvit të mbarë dhe tejkallim të situatës pandemike, që ka shkaktuar jo pak probleme në dy vitet e

fundit për sistemin shëndetësor si dhe për të gjithë qytetarët, të cilët kanë pësuar humbje të mëdha. "Përmes këtij takimi kërkoj nga ju që t'i rritni kapacitetet dhe t'i përmirësoni shërbimet shëndetësore, duke e respektuar në rend të parë orarin e punës si dhe duke e shtuar bashkëpunimin ndërinstitucional. Do të punojmë pa u ndalur që qytetarët e Rahovecit t'i marrin shërbimet e duhura shëndetësore në vazhdimësi", ka thënë kryetari Latifi.

Fillon trajnimi për përgatitjen e grave të reja në ndërmarrësi

PODUJEVË, 20 JANAR - Organizata Help, në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik në komunën e Podujevës, kanë filluar trajnimin dyditor për ndërmarrësi për gratë përfutuese të granteve në projektin "Women Energy

Entrepreneurs", i financuar nga Milenium Foundation Kosovo.

Qëllimi i trajnimit është përgatitja e grave të reja në ndërmarrësi, ndërsa tematikat kryesore që trajton janë administrimi i biznesit dhe siguria në vendin e punës. Komuna e Podujevës

ka njoftuar se gratë përfutuese do të pajisen me makina të rrobaqepësisë, mjete për përgatitjen e ëmbëlsirave dhe pjekurinave të ndryshme, si dhe makineri të tjera që u shërbejnë për bizneset e tyre. Përfutuese të këtij projekti janë 22 gra.



Suedia dhe Kosova fillojnë dekadën e dytë të bashkëpunimit në fushën e auditimit

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 20 JANAR - Komiteti Drejtues i Projektit për bashkëpunim në mes të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Suedisë dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës të enjten kanë mbajtur mbledhjen e rregullt vjetore.

Përfaqësuesit e të dyja institucioneve supreme të auditimit kanë diskutuar për raportin e progresit dhjetor 2020 - dhjetor 2021, reflektimet mbi sfidat, mësimet e nxjerra dhe rreziqet, si dhe për planin e aktiviteteve për vitin 2022 që do të zbatohet në kuadër të projektit "Bashkëpunimi për Zhvillim Institucional me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës 2020-2023".

Me këtë rast auditorja e përgjithshme e Suedisë, Helena Lindberg, dhe auditorja e përgjithshme e Kosovës, Vlora Spanca, kanë vlerësuar lart bashkëpunimin prej një dekade

në mes të dy institucioneve të auditimit, me ç'rast janë zotuar për avancimin e mëtejshëm të këtij bashkëpunimi në dekadën e ardhshme.

Auditorja e përgjithshme e Kosovës, Vlora Spanca, ka thënë se përkrahja profesionale nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë për ZKA-në ka qenë e rëndësishme dhe e gjithanshme për ngritjen e kapaciteteve institucionale në përgjithësi, e në fushën e auditimit të performancës në veçanti. "Bashkëpunimi ynë zyrtar tashmë është i vjetër një dekadë dhe jam e gatshme të vazhdoj miqësinë dhe bashkëpunimin tonë në dekadën e ardhshme. Aktualisht jemi në proces të hartimit të synimeve tona strategjike për tri vitet e ardhshme dhe presim ta vazhdojmë traditën tonë të shkëlqyer të bashkëpunimit me ju", ka deklaruar ajo.

Spanca ka thënë se gjatë këtyre viteve Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës ka bërë një përparim të madh si për ngritjen e



kapaciteteve njerëzore ashtu edhe për rritjen e kredibilitetit të saj si partnere e besueshme për qytetarët e Kosovës dhe Kuvendin, duke u bërë një pjesëmarrës aktiv edhe në familjen ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. "Kemi një agjendë ambicioze për vitet e ardhshme. Do ta vazhdojmë punën tonë të mirë audituese duke përmbushur

mandatin ligjor dhe kushtetues dhe duke siguruar produkte cilësore dhe në kohë", është shprehur auditorja e përgjithshme.

Ndërsa auditorja e përgjithshme e Suedisë, Helena Lindberg, edhe një herë e ka përgëzuar Spancën për emërimin e saj si auditore e përgjithshme, duke theksuar se është shumë e kënaqur që bashkëpunimi ndërmjet tyre do të

jetë jo vetëm dypalësh por, gjithashtu, edhe në kuadër të komunitetit ndërkombëtar të auditimit.

Lindberg është shprehur krenare për arritjet e të dyja institucioneve për realizimin e projektit në kohë të tilla të vështira të krijuara nga pandemia. Sipas saj, puna e përbashkët nga distanca dhe arritja e rezultateve nuk do të ishte e mundur sikur të mos kishte bashkëpunim të mirë dhe të gjatë në mes të dy institucioneve.

Projekti "Bashkëpunimi për Zhvillim Institucional me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës 2020-2023" ka për qëllim të mbështesë ZKA-në për t'i përvetësuar standardet e përditësuar dhe parimet e INTOSAI-t (IFPP) nëpërmjet dy objektivave: forcimin e proceseve të brendshme organizative në ZKA, si dhe zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve për të kryer auditime të performancës me cilësi më të lartë, në mënyrë që ato të jenë sa më të dobishme për palët e interesit.

Kërkohet ambient më i favorshëm për kompanitë vendore



Sipas përlogaritjeve nga disa hulumtime të brendshme, rreth 400 milionë euro në vit shpenzohen në kuadër të transportit të mallrave. Shoqata e Transportuesve Ndërkombëtarë të Mallrave të Kosovës ka kërkuar nga qeveria ambient më të favorshëm për kompanitë vendore

PRISHTINË, 20 JANAR - Shoqata e Transportuesve Ndërkombëtarë të Mallrave të Kosovës (ShTNMK) ka përkrahur veprimet e fundit të ndërmarrja nga Qeveria e Kosovës dhe organet kompetente, siç janë Inspektorati dhe Drejtoria e Transportit Rrugor, në funksion të

zbatimit të ligjit për mbrojtjen e interesave të kompanive transportuese vendore, duke filluar fushatën e gjerë të zbatimit të tyre në terren nga policia dhe dogana për lejet e vendeve të treta për çka kjo shoqatë është e angazhuar që nga themelimi i saj.

"Apelojmë që qeveria të mos ndalet në asnjë formë, apo të vihet nën presion nga faktorët e jashtëm, dhe të vijojë që të krijojë një ambient të favorshëm për veprimtari për kompanitë vendore, e që si veprimtari primare kanë transportin ndërkombëtar të mallrave, e të cilat ballafaqohen me një gamë të gjerë të pengesave dhe madje formave më perfide të diskriminimit në raport me qasjen në tregjet regionale e me gjerë. Konsiderojmë se vetëm përkrahja institucionale e

Republikës së Kosovës na inkurajon që ta vazhdojmë zhvillimin e këtij sektori nga kompanitë vendore", është thënë në njoftimin për medie të ShTNMK-së.

Kjo shoqatë ka theksuar se transporti ndërkombëtar i mallrave është linja jetike e funksionimit të tregtisë, sikur të brendshëm, ashtu edhe të jashtëm.

"Transporti ndërkombëtar i mallrave kontribuon në formalizimin e ekonomisë dhe në mbledhjen e taksave nga institucionet e

Republikës së Kosovës. Sipas përlogaritjeve nga disa hulumtime të brendshme, janë rreth 400 milionë euro në vit që shpenzohen në kuadër të transportit të mallrave. Prandaj, besojmë se zbatueshmëria e plotë e infrastrukturës ligjore do të kontribuojë në zhvillimin e ekonomisë së Kosovës në përgjithësi, marrë parasysh ndikimet indirekte që rrjedhin nga kjo industri", është thënë në njoftimin e Shoqatës së Transportuesve Ndërkombëtarë të Mallrave të Kosovës.

Kush do të paguajë më shumë për rrymë?

PRISHTINË, 20 JANAR - Konfuzion dhe kritika ka shkaktuar propozimi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) në Kosovë për ngritje të tarifave të energjisë së shpenzuar elektrike.

Qytetarë të intervistuar nga "Radio Evropa e Lirë" në Prishtinë nuk e dinë saktë se sa do të jetë rritja për ta, por thonë se, edhe ashtu, paguajnë fatura të larta për rrymën.

Halim Haxholli, pensionist nga Prishtina, thotë se ka paguar 109 euro për faturën e fundit. "E papërbalueshme, o vëlla. Këtë rritje s'mund ta përballojë askush, pa marrë parasysh se çfarë gjendje ka", thotë Haxholli.

Të njëjtin mendim e ka edhe Faik Tenezhdolli, i cili për faturën e fundit ka paguar rreth 120 euro. "Asnjë parametër nuk është në favor të shtrenjtimit të energjisë elektrike. Ky popull është i shtrydhur në të gjitha anët. Japin premtime se deri në prill nuk ka shtrenjtim dhe nëse e bëjnë këtë me bllok-tarifa, atëherë vetëm e dhunojnë këtë popull", thotë Tenezhdolli.

Në bazë të pagesave, si Haxholli, ashtu edhe Tenezhdolli, pritet të jenë në kategorinë e qytetarëve që ZRRE-ja ka propozuar t'u rritet çmimi i energjisë elektrike.

Për ta shpjeguar më thjesht se



çfarë nënkupton propozimi për rritje të çmimit të rrymës, ZRRE-ja i ka ndarë konsumatorët në pesë kategori: A, B, C, D, E. Nëse jeni në kategorinë A, pra nëse gjatë një

muaji shpenzoni 300 kilovatë orë energji elektrike, atëherë çmimi aktual i faturës suaj është 18.87 euro. ZRRE-ja ka propozuar që kjo faturë të rritet në 20.40 euro. Por, me

subvencionim nga qeveria, fatura juaj do të mbetet e njëjtë: 18.87 euro.

Nëse jeni në kategorinë B, apo gjatë një muaji shpenzoni 450 kilovatë, atëherë çmimi aktual i faturës suaj është 27.37 euro. ZRRE-ja ka propozuar që kjo faturë të rritet në 29.66 euro. Por, me subvencionim nga qeveria, fatura juaj do të mbetet e njëjtë: 27.37 euro.

Nëse jeni në kategorinë C, që do të thotë se për një muaj shpenzoni 600 kilovatë, atëherë çmimi aktual i faturës suaj është 35.86 euro. ZRRE-ja ka propozuar që kjo faturë të rritet në 38.92 euro. Por, me subvencionim nga qeveria, fatura juaj mbetet e njëjtë: 35.86 euro.

Nëse jeni në kategorinë D, pra nëse gjatë muajit shpenzoni 800 kilovatë, atëherë çmimi aktual i faturës suaj është 47.19 euro. ZRRE-ja ka propozuar që kjo faturë të rritet në 74.17 euro. Por, me subvencionim nga qeveria, fatura juaj do të jetë: 59.50 euro.

Nëse jeni në kategorinë E, që do të thotë se gjatë muajit shpenzoni 1 000 kilovatë, atëherë çmimi aktual i faturës suaj është 58.52 euro. ZRRE-ja ka propozuar që kjo faturë të rritet në 109.42 euro. Por, me subvencionim nga qeveria, fatura juaj do të jetë: 83.14 euro. Siç shpjegohet në Raportin Konsultativ të ZRRE-së për Shqyrtimin e Jashtëzakonshëm të Tarifave të Energjisë Elektrike, rritja prek vetëm dy kategori të

amvisërive, D dhe E, përkatësisht ata qytetarë që shpenzojnë mbi 800, përkatësisht mbi 1 000 kilovatë. Për kategorinë D, që shpenzon 800 kilovatë orë energji elektrike në muaj, fatura pritet të rritet për 12 euro e 31 centë. Për qytetarët në kategorinë E, që shpenzojnë 1 000 kilovatë orë energji elektrike në muaj, fatura pritet të rritet për 24 euro e 62 centë.

Që rritja e faturave të energjisë elektrike të mos jetë aq e lartë dhe të mos bëhet e papërbalueshme për një kategori të qytetarëve, Qeveria e Kosovës ka ndarë një shumë prej 75 milionë eurosh në formë subvencionimi.

Këto subvencione vlejné edhe për bizneset, të cilat, edhe pas propozimit të ZRRE-së, nëse miratohet, nuk do të kenë rritje të tarifave të energjisë elektrike. Qeveria e Kosovës ka thënë se rritja e faturave për bizneset do të kishte ndikim negativ në ekonomi. "Ngritja e tarifave nuk i ka prekur bizneset. Në këtë mënyrë do të kufizohet ndikimi në rritjen e çmimeve të produkteve dhe shërbimeve që ofrohen në ekonominë tonë", ka thënë kryeministri Albin Kurti.

Subvencionet e qeverisë do të shfrytëzohen për një periudhë njëvjeçare.

Faturat me rritje, në rast se propozimi i ZRRE-së kalon, do të fillojnë nga data 1 shkurt 2022 dhe shqyrtimi i rregullt i tyre pritet të bëhet në muajin mars të vitit 2023.

Në cilën fazë është propozimi i ZRRE-së?

ZRRE-ja ka dalë me propozimin për rritje të faturave më 17 janar, pasi çmimet e energjisë elektrike janë rritur edhe në tregjet evropiane, duke u ndikuar kështu edhe nga çmimet e importeve të Kosovës.

ZRRE-ja, po ashtu, ka thënë se gjatë vitit 2021 është shënuar rritje e ndjeshme e kërkesës për energji elektrike, gjë që ka cenuar sigurinë e furnizimit dhe, javë më parë, ka çuar në reduktime.

Propozimi i ZRRE-së aktualisht është në konsultim publik.

ZRRE-ja i ka ftuar të gjitha palët, përfshirë edhe qytetarët, që të dërgojnë komente, korrigjime apo kundërargumente.

Faza e konsultimit publik do të përfundojë më 28 janar 2022 në orën 18:00.

Pastaj mbetet që ZRRE-ja ta harmonizojë propozimin e saj me komentet e pranuar dhe ta nxjerrë vendimin final. Në rast se propozimi miratohet ashtu siç është, fatura e muajit shkurt do t'u shkojë konsumatorëve me rritje.

Njohësi i fushës së energjisë në Kosovë, Lulzim Sylja, thotë se vendosja e bllok-tarifave nga ana e ZRRE-së mund të ketë ndikim pozitiv në tejkalimin e krizës energjetike, duke mos lejuar që të vihet në rrezik siguria e furnizimit.

Por, Sylja mendon se rritja e propozuar do të duhej t'i përfshinte edhe bizneset, e jo vetëm konsumatorët shtëpiakë. "Ndoshta do të duhej të kishte një diskutim të hapur edhe me biznese, që një pjesë e barrës së kësaj kostoje të zhvendoset në një ngritje të vogël të çmimit të energjisë edhe te bizneset për shkak se pavarësisht prej gjendjes ekonomike që e kemi, energjia elektrike është e lirë edhe te bizneset. Një ngritje sado e vogël te bizneset do ta baraspeshonte peshën e ngarkesës financiare për qytetarët", thotë Sylja.

Ai, po ashtu, thotë se procesi i propozimit të shtrenjtimit të energjisë elektrike nga ZRRE-ja kërkon më shumë qartësime dhe informacione. Sipas tij, ZRRE-ja dhe Qeveria e Kosovës

do të duhej të ishin më të qarta, pasi çdo rritje, sado e vogël, ka ndikim te qytetarët. "Bllok-tarifat janë një mekanizëm i mirë në situata të tilla, në të cilat është Kosova, por jo domosdoshërisht ato [duhet] të jenë 100 për qind më të larta si çmim fundor... Por, duhet të shihet se cili do të jetë ndikimi konkret i këtyre 75 milionë eurove që i ka propozuar qeveria për mbështetje të një grupi të caktuar të këtyre konsumatorëve, që i prek bllok-tarifa e re. Do të thotë, ende kemi nevojë për sqarime shtesë, si nga ZRRE-ja, ashtu edhe nga Qeveria e Kosovës", thotë Sylja. Bllok-tarifat kanë qenë pjesë e strukturës tarifore të energjisë elektrike në Kosovë edhe nga viti 2006 deri në vitin 2017. Sipas atyre, kur një ekonomi familjare ka shpenzuar më shumë se 600 kilovatë rrymë në muaj, çmimi për të ka qenë më i lartë në krahasim me familjet që kanë shpenzuar nën 600 dhe 300 kilovatë në muaj. ZRRE-ja i ka hequr ato rreth pesë vjet më parë.

Ja pse jetojmë në një botë gjithnjë e me kaotike



Nga Richard HAASS
"Council of Foreign Relations"

Libri im "Një botë në kaos", u botua saktësisht 5 vite më parë. Teza kryesore e librit, ishte se fundi i Luftës së Ftohtë nuk solli një epokë më të madhe stabiliteti, sigurie dhe paqeje, siç prisnin shumë njerëz. Përkundrazi, në vend të kësaj ajo që na u shfaq ishte një botë në të cilën konflikti ishte shumë më i përhapur sesa bashkëpunimi.

Në atë kohë, disa e kritikuan librin si tejet negativist dhe pesimist. Në retrospektivë, unë them se libri mund të ishte kritikuar për optimizmin e tij relativ. Në fakt, bota është një vend më i rrëmujshëm nga sa ishte 5 vjet më parë, dhe shumica e tendencave po shkojnë në drejtimin e gabuar. Në nivelin global, hendeku midis sfidave dhe përgjigjeve është i madh dhe në rritje. Pandemia e Covid-19, nxori në pah mangësitë e makinerisë ndërkombëtare shëndetësore. Ne jemi duke hyrë në vitin e tretë të pandemisë, por për shkak të pengesave sistematike nga Pekini, nuk e dimë ende origjinën e saj.

Ajo që ne dimë është se më shumë se 5 milionë njerëz, dhe më shumë gjasa 15 milionë, kanë vdekur tashmë. Gjithashtu dimë se rreth 3 miliardë njerëz (shumica në Afrikë) nuk kanë marrë ende një dozë të vetme të një vaksine anti-Covid. Po ashtu dimë se pandemia e vazhdueshme e ka reduktuar me trilionë dollarë prodhimin ekonomik global. Ndryshimet klimatike kanë

përparuar më tej. Bota është tashmë më shumë se 1 gradë Celsius më e ngrohtë, se sa ishte në fillimin e Revolucionit Industrial, dhe po shkon drejt njëngrohjeje të frikshme. Ngjarjet ekstreme të motit, janë bërë më të shpeshta. Është shtuar përdorimi i karburanteve fosile.

Qeveritë janë zotuar që të bëjnë më mirë në të ardhmen, por kjo mbetet për t'u parë. Në disa raste, si me Kinën dhe Indinë, dy vendet më të populluara në botë, premtimet janë të dukshme për mungesën e ambicies dhe urgjencës së tyre.

Hapësira kibernetike mbetet e ngjashme me Perëndimin e Egër (Eild Eest), pa asnjë "sherif" të gatshëm apo në gjendje që të vendosë kufi ndarës midis sjelljeve të pranueshme atyre të papranueshme. Në të nuk ka një bashkëpunim global.

Përkundrazi, ne po shohim se teknologjia e tejkalon diplomacinë, ndërsa qeveritë autoritare po i izolojnë akoma më tepër shoqëritë e tyre, dhe po shkelin hapësirën kibernetike të tjerëve për të nxitur mosmarrëveshje politike apo vjedhur teknologjinë e tyre.

Nga ana tjetër vazhdon përhapja e armëve bërthamore. Koreja e Veriut e ka shtuar numrin dhe cilësinë e arsenalit të saj bërthamor, por edhe rrezën dhe saktësinë e raketave të saj. Ndërkohë pas vendimit të njëanshëm të SHBA-së në vitin 2018 për të dalë nga marrëveshja, e cila vendosi disa kufij maksimalë të përkohshëm në lidhje me aftësitë bërthamore të Iranit, Republika Islamike ka

kaluar nga 1 vit në vetëm disa muaj apo edhe javë larg zotërimit të një arme bërthamore.

Rivaliteti i fuqive të mëdha, është sot më i theksuar se në çdo kohë që nga Lufta e Ftohtë. Marrëdhëniet SHBA-Kinë janë përqësuar me shpejtësi, kryesisht për shkak të rritjes së represionit kinez në vend, fërkimeve mbi çështjet tregtare dhe ato ekonomike, si dhe fuqisë ushtarake në rritje të Kinës, dhe politikës së saj jashtme gjithnjë e më agresive.

Nën sfondin e konkurrencës ekonomike në rritje, dhe konfliktit të mundshëm mbi Tajvanin, është e paqartë nëse të dyja vendet do të jenë në gjendje të bashkëpunojnë për sfidat globale, si shëndeti publik dhe ndryshimet klimatike. Rusia është ndoshta edhe më e pakënaqur me rendin botëror aktual. Tre dekada pas fundit të Luftës së Ftohtë, presidenti Vladimir Putin, në dukje i vendosur të qëndrojë në krye për të ardhmen e parashikueshme, është i vendosur të ndalë ose nëse është e mundur, ta ndryshojë shtrijën e NATO-s.

Putini ka treguar se ndihet komod kur e përdor forcën ushtarake, furnizimet energjitike dhe sulmet kibernetike si mjete presioni për të destabilizuar vendet dhe qeveritë, të cilat ai i sheh si kundërshtarë. Objektivi i tij i menjëhershëm është Ukraina, por sfida strategjike që paraqitet ndaj Perëndimit nga Rusia e Putinit, është shumë më e gjerë sesa kaq.

Edhe zhvillime të tjera janë jo më pak shqetësuese. Më shumë se 80 milionë – 1 në 100 njëqind njerëz

– janë të zhvendosur nga shtëpitë e tyre. Shumë herë këta njerëz përjetojnë atë që mund të përshkruhet vetëm si një krizë humanitare. Në Lindjen e Mesme zhvillohen vazhdimisht luftëra, që janë njëkohësisht civile dhe rajonale.

Demokracia është në tërheqje në pjesën më të madhe të botës, dhe jo vetëm në raste dramatike si Mianmari dhe Sudani, por edhe në pjesë të Amerikës Latine dhe madje edhe

të Evropës. Haiti dhe Venezuela, janë në thelb shtete të dështuara, ashtu si Libia, Siria dhe Jemeni.

Afganistani po shkon drejt shndërrimit serioz në një lider botëror në terrorizëm, prodhimin e opiumit dhe të mjerimit. Por ekziston edhe një faktor tjetër jetik: Shtetet e Bashkuara gjenden sot në një kos më të madh brenda vendit, se sa ishin 5 vjet më parë.

Polarizimi politik është në kulmin e të gjitha kohërave, ndërsa dhuna politike është shfaqur si një kërcënim tepër serioz. Transferimi paqësor i pushtetit politik pas zgjedhjeve, nuk mund të merret më si diçka e mirëqenë. Ky realitet i brendshëm, e ka përsheptuar tërheqjen e Amerikës nga liderhipi global pas më shumë se treçerek shekulli.

Asnjë vend tjetër nuk është në gjendje, dhe nuk dëshiron që ta marrë këtë rol. Sigurisht, meritojnë të përmenden disa zhvillime pozitive: zhvillimi i shpejtë i vaksinave që reduktojnë në mënyrë dramatike cenueshmërinë ndaj Covid-19; teknologjitë e reja të gjelbra që reduktojnë varësinë nga lëndët djegëse fosile; bashkëpunimi në

rritje midis SHBA-së dhe disa prej aleatëve të saj për t'i kundërvënë një Kinë më të fuqishme; dhe fakti që deri më tani, rivaliteti i fuqive të mëdha nuk ka degraduar në një luftë midis tyre.

Po çfarë do të duhej për të shmangur një të ardhme të diktuar nga kaosi? Një listë e shkurtër do të përfshinte vaksinimin e gjerë kundër Covid-19, dhe vaksinat e reja efektive kundër varianteve të ardhshme;

një përparim teknologjik ose diplomatik, që do të reduktonte ndjeshëm përdorimin e lëndëve djegëse fosile, dhe do të ngadalësonte ndryshimin e klimës; një zgjidhje politike në Ukrainë që të promovojë sigurinë evropiane, dhe një pakti i ri me Iranin që e pengon këtë të fundit të shndërrohet në një fuqi bërthamore apo edhe gati bërthamore;

një marrëdhënie SHBA-Kinë që është në gjendje të vendosë disa kufij për të menaxhuar konkurrencën dhe për të shmangur konfliktin; dhe një SHBA që t'ia dalë të riparojë shumë nga të metat aktuale të demokracisë së saj, në mënyrë që të ketë kapacitetin për t'u fokusuar mbi ngjarjet botërore.

Si gjithmonë, për mirë a keq, pak nga këto gjëra janë të pashmangshme. Por ajo që është e qartë, është se tendencat nuk do të përmirësohen vetvetiu. Për të kthyer tendencat në drejtimin e duhur duhen inovacione, diplomaci dhe një vullnet kolektiv. Për fat të keq, këto të fundit mungojnë./Bota.al

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Klubet e futbollit mbushin 'bateritë' në Turqi



Shumica e klubeve të Superligës së Kosovës në futboll janë duke u përgatitur në Turqi për sezonin pranveror. Këto klube kanë planifikuar të zhvillojnë edhe disa ndeshje miqësore në mënyrë që të jenë sa më të përgatitura për vazhdimin e kampionatit. Sot (e premte) në Turqi shkon edhe skuadra e Llapit, e cila do të zhvillojë përgatitje 13-ditore

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 20 JANAR - Shumica e skuadrave të BKT Superligës së Kosovës në futboll janë duke i mbushur "bateritë" në Turqi për sezonin pranveror. Skuadra e Ballkanit, që është pretendente për titull, ka njoftuar se është duke u stërvitur nga dy herë në ditë dhe se stafi teknik është duke i ngarkuar maksimalisht futbollistët. "Gjendja e futbollistëve është shumë e mirë dhe kushtet janë optimale për fazën përgatitore", thuhet në njoftimin e Ballkanit. Skuadra e dytë në tabelë, Drita, që synon të luftojë për titull, e ka zhvilluar ndeshjen miqësore ndaj Floridsdorfer AC, ku edhe ka shënuar fitore me rezultat 2-

0. Ky klub do t'i zhvillojë gjithsej katër ndeshje miqësore. Skuadra tjetër nga qyteti i Gjilanit, Gjilani, që është lider i elitës, ka bërë publike se do t'i zhvillojë katër ndeshje miqësore.

Skuadra e Ismet Munishit sot (e premte) përballat me Yverdon-Sport FC. Kundërshtarë të tjerë të kësaj skuadre janë edhe FC Chayka Peschanokopskoye, FC Shakhter Karagandy dhe Gaziantep F.K.. Ndërkohë skuadra e Llapit në orët e para të ditës së premte është nisur drejt Antalisë. Sipas njoftimit të këtij klubi, skuadra llapjane do të vendoset në hotelin luksoz "Aska Lara Resort & Spa". "KF Llapi niset drejt Antalisë për zhvillimin e fazës përgatitore prej 13-ditësh para fillimit të kampionatit dhe ndeshjeve të

Kupës. Ekipi do të akomodohet në hotelin luksoz 'Aska Lara Resort & Spa' për periudhën e qëndrimit nga data 21 janar deri më 3 shkurt. Përveç stërvitjeve intensive nga dy herë në ditë, ekipi do t'i luajë edhe pesë ndeshje kontrolluese për ta parë gjendjen reale para shumë sfidave me rëndësi që na presin në edicionin pranveror", thuhet në njoftimin e Llapit.

Edhe skuadra e Prishtinës është vendosur në Antalia të Turqisë ku po stërvitet nga dy herë në ditë. Në Turqi janë duke e zhvilluar fazën përgatitore edhe Dukagjini i Klinës dhe Malisheva. Skuadrat e tjera, Feronikeli, Drenica dhe Ulpiana, nuk kanë bërë asnjë njoftim se do t'i vazhdojnë përgatitjet jashtë vendit.

SHKURT

Ismet Krasniqi viziton Komitetin Paralimpik të Kosovës

Presidenti Ismet Krasniqi ka vizituar Komitetin Paralimpik të Kosovës, me ç'rast është prititur nga presidentja Njomza Emini. Presidenti Krasniqi ka përgëzuar KPK-në për inaugurimin e zyrave të reja derisa i ka ofruar mbështetje KOK-ut në proceset që e presin. Nga ana e saj, presidentja Emini ka falënderuar presidentin Krasniqi për vizitën dhe ka shprehur mirënjohjen për bashkëpunimin dhe përkrahjen e vazhdueshme.

Kupa e Kosovës për vitin 2022 zhvillohet në Pejë

Kupa e Kosovës për vitin 2022 do të zhvillohet në Pejë nga data 9 shkurt deri më 13 shkurt. Lajmin e ka dhënë skuadra e Pejës përmes një postimi në "Facebook". "Ky edicion i Kupës do të organizohet në kujtim dhe nderim të Agim Llukës si një ndër themeluesit dhe financuesit e parë të KB Peja, i cili pak kohë më parë ndërroi jetë. Premtojmë spektakël, super organizim dhe 'show' basketbollistik në follenë e shqiptonjave", ka njoftuar KB Peja.

'Gazzetta dello Sport' vlerëson lart Bajramin dhe Asllanin

Nedim Bajrami dhe Kristjan Asllani bënë një paraqitje fantastike në ndeshjen kundër Interit. Mesfushori i kombëtares shqiptare u aktivizua në fillim të pjesës së dytë në ndeshjen e Kupës së Italisë kundër Interit dhe shënoi golin e barazimit 1-1 falë një asistimi të të riut që është pjesë e Shqipërisë U21. Asllani ishte në formacion dhe u zëvendësua në shtesën e parë të ndeshjes. "Gazzetta dello Sport" vlerësoi pozitivisht dy futbollistët shqiptarë. Bajrami vlerësohet me notën 7.5, kurse Asllani vlerësohet me notën 6.5.

Djokoviçi rrezikon të zbrësë nga fronti pas mungesës në Australian Open

Mungesa në grand slam të Australian Open mund t'i kushtojë shumë tenistit serb Novak Djokoviçi, që rrezikon ta humbasë kreun e renditjes botërore. Ai është kampion në fuqi në këtë turne, por për shkak të përjashtimit nga Australia, Djokoviçi (i pavaksinuar) nuk mund ta mbrojë këtë titull. Ndaj, si pasojë e pikëzimit, ai do të humbasë 2 000 pikë. Kjo mund të çojë në rrëzimin e tij nga fronti në rast se këtë turne e fitojnë numrat 2 dhe 3 në botë, respektivisht rusi Daniil Medvedev e gjermani Alexander Zverev, që në këtë rast do të fitonin 2 000 pikë. Kjo gjë mund të ndodhë zyrtarisht në mesin e shkurtit, pasi vjet Australian Open u shty dy javë për shkak të pandemisë.

Trajneri i Southamptonit: Lëreni Brojën të luajë futboll

SOUTHAMPTON, 20 JANAR - Shqiptari është huazim deri në fundin e sezonit, mirëpo pa opsion blerje, derisa Southamptoni është duke provuar ta bindë Chelsea ta shesë. Ka pasur negociata mes

dy klubeve, por nuk është arritur ndonjë marrëveshje ngaqë "blutë" e shohin Brojën si lojtar i së ardhmes. I pyetur për mundësinë e blerjes të Brojës, trajneri i Southamptonit, Ralph

Hasenhuttl, ka thënë se duhet ta lejojnë të luajë, ngaqë ka kohë deri në fundin e sezonit. "Është këtu deri në fundin e sezonit. Kemi kohë mjaftueshëm për të folur. Lëreni të luajë futboll. Ai

kënaqet këtu. Mendoj se e ka parë se çfarë ka me këtë klub. I japim shansin e madh për ta treguar vetën", ka thënë Hasenhuttl. Ndërkohë, në rast që pranon shitjen, Chelsea do të kërkojë mbi 20 milionë euro.



Ronaldos nuk i pëlqeu zëvendësimi, Ragnick: I thashë se do të më kuptosh kur të bëhesh trajner

MANCHESTER, 20 JANAR - Në ndeshjen që Manchester Unitedi e fitoi me rezultat 1-3, përballë Brentfordit, Cristiano Ronaldo luajti si titullar, por Ralf Rangnick e zëvendësoi në minutën e 71-të me Harry Maguire. Ylli portugez nuk e priti

mirë vendimin e trajnerit gjerman, të cilit iu drejtua me këto fjalë në momentin që doli nga fusha: "Përse më zëvendësove?!". Pasi e përqafoi Rangnick, CR7 hodhi në tokë xhupin e tij dhe i kërkoi llogari trajnerit. Ky i fundit iu afrua

sulmuesit për t'i shpjeguar vendimin e tij, teksa deklaroi këto fjalë pas ndeshjes: "I thashë: e kuptoj që je ende ambicioz dhe dëshiron të shënosh por ndoshta, pas disa vitesh, kur të jesh trajner, mund të marrësh një vendim të ngjashëm kur të

gjendesh në të njëjtën situatë si unë. Ia bëra të qartë se mora vendimin në interes të skuadrës. Kundër Aston Villës po kryesonim 0-2 pesë ditë më parë, por barazoi. Nuk doja të ndodhte përsëri ashtu. Mendoj se mora vendimin më të mirë".



FIFA paraqet rregulloren e re për transferimin e futbollistëve

NYON, 20 JANAR - FIFA paraqiti rregulloret e reja që ka hartuar për transferimin e futbollistëve ndërkombëtarë me qëllim "zhvillimin e lojtarëve të rinj, promovimin e ekuilibrit konkurrues dhe shmangien e grumbullimit të futbollistëve", njoftohet përmes një deklarate. Fillimisht, do të jetë e nevojshme të nënshkruhet një marrëveshje për t'i përcaktuar të gjitha kushtet e transferimeve, veçanërisht kushtet kohore dhe ekonomike. Do të ketë një kohëzgjatje minimale për detyrën, e cila do të jetë midis dy periudhave të merkatove dhe maksimumi një vit. Për më tepër, rregullorja e re ndalon transferimin e lojtarëve që janë tashmë në huazim në një klub të tretë dhe kufizon numrin e transferimeve në sezon midis dy klubeve në tre lojtarë, si për të



marrë transferime ashtu edhe për t'u transferuar. Në të njëjtën mënyrë çdo klub do të ketë një maksimum huazimi në sezon, shifër kjo që do të ulet me kalimin e sezoneve: "Nga 1 korriku 2022 deri më 30 qershor 2023, një klub mund të huazojë maksimumi tetë profesionistë dhe të përfshijë tetë profesionistë në huazim në çdo kohë gjatë një sezoni", sqaroi FIFA. Megjithatë, do të ketë shtatë lojtarë për sezonin 2023-24 dhe

gjashtë nga sezoni 2024-25. Nga këto kufizime do të përjashtohen të gjithë lojtarët deri në 21 vjeç, si dhe futbollistët e trajnuar nga klubi. Synimi i FIFA-s është që rregullat të hyjnë në fuqi më 1 korrik 2022 pasi pandemia e krijuar nga Covid-19 ka shkaktuar vonesë në zbatimin e një rregulloreje që është pjesë e reformës së përgjithshme të sistemit të transfertave që filloi institucioni në vitin 2017.

Brooklyni triumfon në frymën e fundit

WASHINGTON, 20 JANAR - Kampionët e Milwaukee fituan me rezultat 126-114 ndaj Memphisit, ndeshje mes dy ekipesh pretendente për titull këtë sezon. Ndeshje magjike e Antetokounmpo, me 33 pikë e 15 rebounde, duke i bërë të pavlefshme 33 pikët e 14 asistimet



e Morantit për miqtë. Në sekondën e fundit fiton ekipi i Brooklynit, që mundi me rezultat 119-118 Washingtonin jashtë fushës, ndeshje ku u dallua Irvingu, autor i 30 pikë. Zhgënjëjnë sërish lakersat, që në fushën e tyre u mundën 111-104 nga Indiana, me LeVert protagonist, autor i 30

pikëve. Në krye të renditjes në lindje ngjitet Chicago, që mundi 117-104 Cleveland (DeRozani, 30 pikë), ndërsa Miami fitoi 104-92 ndaj Portlandit (Martini, 26 pikë). Pas kohës shtesë triumfoi Denveri, që mposhti me rezultat 130-128 clippersat (Jokiçi, 49 pikë, 14 rebounde, 10 asistime).

REZULTATET

Philadelphia - Orlando	123-110
Washington - Brooklyn	118-119
Atlanta - Minnesota	134-122
Boston - Charlotte	102-111
Miami - Portland	104-92
Chicago - Cleveland	117-104
Milwaukee - Memphis	126-114
Dallas - Toronto	102-98
San Antonio - Oklahoma	118-96
Utah Jazz - Houston	111-116
Denver - Clippers	130-128
Sacramento - Detroit	131-133
Lakers - Indiana	104-111

SHKURT

Saint-Etienne në garë për Muriqin

Sulmuesi Vedat Muriqi pritet të bëhet me skuadër të re brenda këtij muaji. Klubi i njohur francez, Saint-Etienne, e ka bërë prioritet nënshkrimin me Muriqin në këtë afat dimëror. Dy probleme kryesore mbesin që të arrihet marrëveshja, fillimisht Muriqi ka kontratë me Lazio deri në vitin 2025 dhe klubi italian kërkon para që ta lejojë huazimin. Problemi i dytë është kërkesat e Lazios që do të jenë të larta, duke marrë parasysh se kosovarin e duan edhe klubet si Leeds Unitedi, Hull City dhe Fenerbahçe. Në ditët e ardhshme pritet të takohen Saint-Etienne me Lazio për të parë nëse do të arrijnë marrëveshje dhe në rast që nuk gjejnë 'gjuhën e përbashkët', atëherë francezët do të fokusohen te sulmuesi i Rapid Viennas, Ercan Kara.

Emma Raducanu mposhtet nga Danka Koviniq

Emma Raducanu është eliminuar nga Australian Open në raundin e dytë pasi humbi nga numri 98 i botës, Danka Koviniq, në tre sete. Raducanu filloi në mënyrë të përkryer në Melbourne Park, duke rrëmbyer avantazhin e hershëm 3-0 në setin e hapjes. Sidoqoftë, adoleshentja britanike më pas u dorëzua në dy ndeshjet e radhës, para se një dëmtim i vogël t'i përkeqësonte gjërat. Raducanu barazoi ndeshjen, duke fituar setin e dytë 6-4. Por ajo përfundimisht humbi 6-3 në setin e fundit për t'u eliminuar nga Australian Open. Tenistja angleze arriti të fitojë tournamentin në US Open vitin e kaluar në një moshë shumë të re. Humbja 6-4, 4-6, 6-3 shënon herën e parë që 19-vjeçarja është mposhtur në një ndeshje Grand Slam, me humbjen e vetme të mëparshme në raundin e katërt të Wimbledonit vitin e kaluar.

Blessini emërohet trajner i Genoas

Pasi italo-gjermani Bruno Labbadia hodhi poshtë ofertën e Genoas në minutën e fundit, Genoa ka gjetur tashmë një trajner të ri për ta zëvendësuar Shevchenkon. Alexander Blessin u rekrutua nga Oostende dhe nënshkroi një kontratë të vlefshme deri në vitin 2024. 48-vjeçari më parë ka drejtuar Oostenden deri në vitin 2020, i renditur i 16-të në kampionatin belg.

Atletico nuk e shet Suarezin

Sulmuesi Luis Suarez do të vazhdojë të luajë në Atletico Madrid, të paktën deri në verë. Ishte raportuar se Atletico mund ta shesë ish-sulmuesin e Barcelonës në afatin kalimtar të janarit, me Aston Villën që interesohet për uruguaijanin. Steven Gerrard dëshiron ta rikthejë në Premierligë, të ribashkohet me të në "Villa Park". Por, edhe pse Suarezin ka rënë shumë në formë, Atletico s'e ka ndër mend ta shesë në afatin e janarit.

Gazeta spanjolle pretendon se Mbappe ka arritur marrëveshje me Realin

Kylian Mbappe ka rënë dakord të nënshkruajë një marrëveshje gjashtëvjeçare me Real Madridin me një bonus nënshkrimi prej 40 milionë eurosh dhe një pagë vjetore prej 21 milionë eurosh plus bonuse dhe 50 për qind të reklamave dhe

marketing tregtar, raporton "ABC Deportes". Raporti detajon se Reali duhet së pari të informojë PSG-në se janë duke negociuar zyrtarisht me Mbappen përpara se ta ndërmarrë nënshkrimin zyrtar më 1 korrik. Gjithashtu, lojtari

kërkoi të vonojë gjithçka për të luajtur në raundin e 16 të Ligës së Kampionëve kundër Realit pa këtë presion shtesë. Megjithatë, 'presioni' i skuadrës së Ligës 1 është intensiv. Real Madridi beson se lojtari nuk do t'i nënshtrohet presionit dhe

do ta respektojë ofertën e marrëveshjes. Për më tepër, Real Madridi mbështetet në fjalën e Mbappes për ta nënshkruar kontratën e tij të ardhshme në korrik, dhe nëse ai do të qëndronte në PSG tani, ai do të mbyllte atë derë - nuk do të kishte asnjë

ofertë të ardhshme për sulmuesin. Me raportet e fundit se gjigantët francezë planifikojnë ta emërojnë ish-trajnerin e Real Madridit, Zinedine Zidane, mund të jetë "karta e egër" për ta tunduar francezin që të qëndrojë.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "LIKA" D.O.O. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811122986, ul Nicole Tesla br 1, Zveqan, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "LIKA" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811122986, ul Nicole Tesla br 1, Zveqan, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "LIKA" D.O.O. has come to the decision to quit its business: 811122986, ul Nicole Tesla br 1, Zveqan, the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Kompania "MAXIMAL" SH.P.K me seli në Prizren ka marr vendim të shuajë biznesin me numër të regjistrimit 810063305 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore-Debitorë në këtë shoqëri që të paraqiten në afatin 30 - ditore nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavještavamo klijente da Tvrtka "MAXIMAL" DOO u Prizren deneo odluku da ugasi biznis po br.registra 810063305 I ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postuaka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze I potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all clients that the Company "MAXIMAL" SH.P.K based in Prizren has taken the decision to terminate the business with registration number 810063305 and has appointed the liquidator to conduct the Liquidation procedure. All clients who have Credit-Debit reports in this company are notified to be presented within 30 days from the date of publication in the newspaper.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Shemsedin Elezi, shpall të pavlefshme, e (dëmtuar) diplomën me nr.99-UP- "Hasan Prishtina" drejtimi Menaxhment Informatikë.
- ▶ Resmije Hasi nga Gjakova, shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të SH.F. "Mazllum Këpuska" Gjakovë.
- ▶ Lulzim Xhafiqi shpall te pavlefshme 3 dëftesa, diplomën , certifikatën e notave dhe mungesave shmlt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ "ADE-MAN" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr: 810039629.
- ▶ Qemal Hoti Dejne KK Rahovecit shpall të pavlefshme dëftesat e kl, I,II, III,IV dhe diplomën e Gjmnazit "12 Maji" Ratkoc KK Rahovec.
- ▶ Kosovare Makshana Drenoc KK Rahovec shpall të pavlefshme dëftesat e kl, X,XI,XII dhe diplomën SH.M. Teknike " Nexhmedin Nixha" Gjakovë-Dizajn .
- ▶ Mikel Ibishaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X,XI, XII dhe diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- ▶ Egzon Pruthi nga Gjakova, shpall të pavlefshme dëftesën e plotë SH.F.M.U. "Selman Riza" Gjakovë.
- ▶ Eron Mehmeti shpalle te pavlefshme dëftesën e klasës se 10-te te SHMLT "Arkitekt Sinani".
- ▶ D.P.T " Erza" Shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb : 70046338.
- ▶ Kimete Xhafa shpalle te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Rifat Vidishiqi" .
- ▶ Qendrim Kajtazi shpalle tre pavlefshme diplomën e SHMLT "Anton Ceta".
- ▶ Nazmi Kajtazi shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLT "Arkitekt Sinani".
- ▶ Xhevat MAnjollli shpalle te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Azem Bejta".
- ▶ Ilir Sa .Sylejmani B.I shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb: 811495284
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Duke u bazuar në Ligjin nr. 03/L-073, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 66 paragrafi 1 dhe 2, Udhëzimin Administrativ nr. 01/2012 për Emërimin dhe Shkarkimin e KE, ZVKE i SKQZ, Drejtorit Ekzekutiv të ZRPPC-së dhe Zëdhënësit për Informim, Vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të datës 12. 08. 2020 nr. 729 / 2020 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ nr. 01/2012 për Emërimin dhe Shkarkimin e KE, ZVKE i SKQZ, Drejtorit Ekzekutiv të ZRPPC-së dhe Zëdhënësit për Informim, Udhëzimit Administrativ nr.01/2022, i ndryshuar dhe i plotësuar për Emërimin dhe Shkarkimin e KE, ZVKE i SKQZ, Drejtorit Ekzekutiv të ZRPPC-së dhe Zëdhënësit për Informim, Rregullores nr. 01/2017, për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, neni 4, neni 9 dhe neni 11, Rregullores nr. 03/2017, për Procedurat e Rekrutimit, Emërimit dhe Punës Provoese të Nëpunësve të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si dhe vendimit nr. 134/2022 .të datës 21.01.2022 të KQZ-së, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shpallë:

KONKURS

1. KQZ- 01/2022 Zëvendës Krveshef Ekzekutiv në SKQZ

Grada/Koeficienti: Niveli Drejtues- ND - G2 / K- 19.35
Mbikëqyrësi i drejtëpërdrejtë: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Kohëzgjatja e emërimit: Me afat të caktuar
Vendndodhja : Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të vendit të punës

- Me autorizimin e KE-së, mbikëqyrë dhe koordinon bashkëpunimin në mes të Departamenteve të Sekretariatit të KQZ-së;
- Në mungesë të KE-së, të gjitha përgjegjësitë dhe detyrat me autorizim kalojnë te zv. KE;
- Përfaqëson KE—në ose Sekretariatit kur kjo i kërkohet;
- Ndihmon Kryeshëf Ekzekutiv në çështjet që kanë të bëjnë me menaxhimin dhe administrimin e KQZ-së, kur kjo kërkohet nga KE;
- Detyra dhe përgjegjësi të tjera që i caktohen nga mbikëqyrësi.

Kualifikimi, aftësitë dhe përvoja e punës:

- Të ketë diplomë universitare në drejtësi, ekonomi,shkenca politike, administratë publike;
- Përvojë pune së paku gjashtë (6) vite, duke përfshirë katër (4) vite përvojë menaxheriale,
- Fleksibilitet dhe aftësi për të punuar nën presion dhe në afate të shkurtra kohore,
- Aftësi dhe gatishmëri për të punuar me njerëz të përkatësive të ndryshme etnike,
- Njohje e teknologjisë informative, (MS Word, MS Excel dhe MS Access),
- Njohje e mirë e gjuhës tjetër zyrtare,
- Njohja e gjuhës angleze e dëshirueshme.

2. KQZ- 02/2022 Drejtor Ekzekutiv i Zyrës për Regjistrim dhe Certifikim të Partive Politike

Grada/Koeficienti: Niveli Drejtues- ND - G2 / K- 19.35
Mbikëqyrësi i drejtëpërdrejtë: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Kohëzgjatja e emërimit: Me afat të caktuar
Vendndodhja : Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të vendit të punës

- Përgjegjës për administrimin dhe menaxhimin e përgjithshëm të zyrës.
- Siguron që funksionet e zyrës të zbatohen në përputhje me akte ligjore, nënligjore ne fuqi dhe vendimet e KQZ-së;
- Përgatit raporte dhe i rekomandon KQZ-së;
- Koordinon aktivitetet me Sekretariatit e KQZ - së dhe PZAP-in;
- Mbikëqyrë, hartimin e akteve nënligjore që kanë të bëjnë me Zyrën dhe bën planin për aktivitetet e punës së Zyrës;
- Këshillon dhe udhëzon subjektet politike lidhur me obligimet ligjore ndaj KQZ-së;
- Përfaqëson Zyrën brenda dhe jashtë institucionit;
- Menaxhon punët dhe stafin e Zyrës;
- Detyra dhe përgjegjësi të tjera që i caktohen nga KQZ-ja;

Kualifikimi, aftësitë dhe përvoja e punës:

- Diplomë Universitare në Drejtësi, Administratë publike, Shkenca Politike;
- Përvojë pune së paku gjashtë (6) vite, duke përfshirë katër (4) vite përvojë menaxheriale.
- Integritet të lartë personal dhe profesional
- Shkathësi të shkëlqyeshme për hartim dhe shprehje me shkrim
- Aftësi dhe gatishmëri për të punuar me njerëz të përkatësive të ndryshme kulturore dhe etnike;
- Njohja e gjuhës tjetër zyrtare e obligueshme;
- Njohje e gjuhës angleze e dëshirueshme;
- Njohje të teknologjisë informative (MS Word, MS Excel dhe MS Access).

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Zyra e Personelit, dhoma nr. 21, kati I-rë, Ish Ndërtesa e Bankës së Lubjanës,, Rruga "Migjeni" 10000 Prishtinë. Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni në numrin e tel: 038-200-23-557, prej orës 08:00 – 16:00, ose vizitoni ueb faqen e KQZ-së, në linkun: www.kqz-ks.org. Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 4 ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për vendin e punës për të cilin konkurroni, certifikatën valide jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj që nuk jeni nën hetime si dhe dy formularët e fundit të vlerësimit nga institucioni ku keni punuar.

Kandidatët të cilët aplikojnë për këto pozita, do të njoftohen për statusin e aplikacionit të tij/saj në mënyrë të vazhdueshme, me shkrim nga zyra e personelit. Kandidatët të cilët do të jenë të përzgjedhur dhe të ftuar në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.

Publikimi i konkursit bëhet në ueb faqen e KQZ-së, dhe shtypin ditor, i hapur do të jetë prej datës: 21 janar 2022 deri me datë: 07 shkurt 2022 në ora 16:00.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe inkurajon aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore, si dhe pjesëtarët e të gjitha komuniteteve në Kosovë, përfshirë personat me aftësi të kufizuara.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Na osnovu Zakona br. 03 / L-073 o opštim izborima u Republici Kosovo, član 66 stav 1 i 2, Administrativnog uputstva br. 01/2012 o imenovanju i razrešenju GIS-a / zam.GIS-a / SCIK-a, Izvršnog direktora KRPPP-a i Portparola za informisanje, Odluci Centralne izborne komisije od 12.02.2020 br.729/2020 o izmeni i dopuni Administrativnog uputstva br. 01/2012, o imenovanju i razrešenju GIS-a / zam.GIS-a / SCIK-a, Izvršnog direktora KRPPP-a i Portparola za informisanje, Administrativnog uputstva br.01/2022, izmenjenog i dopunjenog, o imenovanju i razrešenju GIS-a / zam.GIS-a / SCIK-a, Izvršnog direktora KRPPP-a i Portparola za informisanje, Uredbe br. 01/2017, o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta u Sekretarijatu Centralne izborne komisije, član 4, član 9 i član 11, i Uredbe br. 03/2017, o procedurama regrutovanja, imenovanja i probnog rada službenika Sekretarijata Centralne izborne komisije i Odluke CIK-a br. 134/2022, 21.01.2022 . godine, Centralna izborna komisija objavljuje:

KONKURS

1. CIK- 01/2022 Zamenik Glavnog Izvršnog Službenika SCIK-a

Stepen/Koeficijent: Upravni nivo- UN - G2 / K- 19.35
Direktni nadzornik: Centralna izborna komisija
Trajanje imenovanja: Na određeno vreme
Mesto: Priština

Glavni zadaci i odgovornosti radnog mesta

- Uz ovlašćenje GIS-a nadzire i koordinira saradnju između Odeljenja Sekretarijata CIK-a;
- U odsustvu GIS-a, sve odgovornosti i zadaci prelaze na Zamenika GIS-a;
- Zastupa GIS-a ili Sekretarijat, kada se to od njega traži;
- Pomaže Glavnom Izvršnom Službeniku u pitanjima koja su u vezi sa upravljanjem i administracijom CIK-a, kada to zahteva GIS;
- Ostale dužnosti i odgovornosti koje mu je odredio nadzornik.

Kvalifikacije, sposobnosti i radno iskustvo:

- Univerzitetska diploma iz oblasti prava, ekonomije, političkih nauka, javne uprave;
- Najmanje šest (6) godina radnog iskustva, uključujući četiri (4) godine rukovodilačkog iskustva,
- Fleksibilnost i sposobnost za rad pod pritiskom i u kratkim vremenskim rokovima,
- Sposobnost i spremnost da rade sa ljudima različite etničke pripadnosti,
- Poznavanje informativne tehnologije, (MS Word, MS Excel i MS Access)
- Dobro poznavanje drugog službenog jezika,
- Poznavanje engleskog jezika je poželjno,

2. CIK- 02/2022 Izvršni Direktor Kancelarije za Registraciju i Potvrđivanje Političkih Partija

Stepen/Koeficijent: Upravni Nivo- UN - G2 / K- 19.35
Direktni nadzornik: Centralna izborna komisija
Trajanje imenovanja: Na određeno vreme
Mesto: Priština

Glavni zadaci i odgovornosti radnog mesta

- Odgovoran za administraciju i opšte upravljanje kancelarijom.
- Obezbeđuje da se funkcije Kancelarije sprovode u skladu sa zakonskim aktima, podzakonskim aktima i odlukama CIK-a;
- Priprema izveštaje i preporučuje CIK-u;
- Koordinira aktivnosti Sekretarijata CIK-a i IPŽP-a;
- Nadgleda izradu podzakonskih akata koji se odnose na Kancelariju i sastavlja plan za radne aktivnosti Kancelarije
- Savetuje i upućuje političke subjekte u vezi sa zakonskim obavezama prema CIK-u;
- Predstavlja Kancelariju unutar i van institucije;
- Rukovodi kancelarijom i osobljem Kancelarije;
- Ostali zadaci koje odredi CIK.

Kvalifikacije, sposobnosti i radno iskustvo:

- Univerzitetska diploma iz oblasti Prava, Javne Administracije, Političkih nauka;
- Najmanje šest (6) godine radnog iskustva uključujući četiri (4) godine rukovodilačkog iskustva.
- Visoki lični i profesionalni integritet,
- Odlučne veštine u sastavljanju i pismenom izražavanju,
- Sposobnost i spremnost da rade nepristrasno i sa ljudima različite etničke i kulturne pripadnosti;
- Poznavanje drugog službenog jezika obavezno;
- Usmeno i pismeno poznavanje engleskog jezika poželjno;
- Poznavanje Informativne tehnologije (MS Word, MS Excel dhe MS Access).

Aplikacije se mogu preuzeti i predati u Sekretarijatu Centralne izborne komisije, Kadrovska kancelarija, Kancelarija br.21, sprat I-vi, bivša zgrada Ljubljanske Banke,Ulica "Migjeni" 10000 Priština.

Za detaljnije informacije, možete stupiti u kontakt sa osobljem Kadrovske kancelarije na br. tel: : 038-200 23 557, od 08:00 – 16:00, ili posetite web-stranicu CIK-a, na linku: www.kqz-ks.org. Aplikacije poslate putem pošte, na kojima je poštanski pečat pošiljke sa datumom zadnjeg dana konkursa, će se uzeti u obzir i razmotriti, ukoliko iste pristignu u roku od 4 dana. Aplikacije koje pristignu nakon ovog roka i nekompletirane aplikacije se neće uzeti u obzir. Aplikaciji priložite kopiju dokumentacije o vašim kvalifikacijama, radno iskustvo i ostalu neophodnu dokumentaciju koja se zahteva za ovo radno mesto za koje vi konkurirate, potvrda da niste pod istragom, ne stariju od 6 (šest) meseci kao i dva zadnja obrasca vašeg ocenjivanja iz institucije u kojoj ste ranije radili.

Kandidati koji se prijave za ove pozicije biće kontinuelno pismeno obavesteni od strane kadrovske kancelarije o statusu njegov/njene prijave. Kandidati koji budu izabrani i pozvani na intervju treba da dostave na uvid originalna dokumenta.

Objavljuvanje konkursa vši se na web stranici CIK-a i dnevnoj štampi, bice otvoren od: **21 januara 2022 do 07. februara 2022 u 16:00 časova.**

Centralna izborna komisija pruža jednake mogućnosti za zapošljavanje svim građanima Kosova i podstiče prijave svih osoba muškog i ženskog roda, kao i pripadnika svih zajednica na Kosovu, uključujući osobe sa ograničenim sposobnostima.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

